

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Niveli: Master- Penal

Tema: Vepra penale e rrezikimit të trafikut publik në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Drenas gjatë periudhës kohore 2015-2019

Mentori: Prof. Dr. Haki DEMOLLI

Kandidatja: Valbonë HOXHA

ABSTRAKT

Trafiku publik është veprimtari e dobishme dhe e domosdoshme në ditët e sotme. Qarkullimi i njerëzve dhe i mallrave tani bëhet për një kohë të shkurtër. Nëpërmjet zhvillimit të trafikut publik është lehtësuar jeta e njerëzve. Mirëpo trafiku publik konsiderohet edhe si veprimtari e rrezikshme, pasi që shumë njerëz pësojnë lëndime apo humbin jetën dhe shkaktohen dëme të mëdha materiale për shkak të pakujdesisë së drejtuesve të mjeteve motorike.

Pjesëmarrësit në trafikun publik janë të obliguar që të respektojnë rregullat e trafikut publik. Respektimi i këtyre rregullave do të zvogëlonte mundësinë e shkakimit të aksidenteve. Edhe pse trafiku publik mbikëqyret nga policia dhe legjislacioni përmban mjaft norma të cilat duhet të zbatohen me rastin me marrjes pjesë në trafikun publik, prapë se prapë aksidentet në trafikun publik ndodhin, madje në raste të caktuara edhe me pasoja fatale.

Në legjislacionin tonë penal janë paraparë disa vepra penale me anën e të cilave sanksionohen veprimet e kundërligjshme në trafikun publik. Një prej veprave penale që më së shpeshti kryhet në trafikun publik është rrezikimi i trafikut publik. Në bazë të elementeve të figurës së kësaj vepre penale rezulton se kjo vepër penale ka karakter të përgjithshëm dhe aplikohet vetëm në rastet kur nuk konsumohen elementet e veprave tjera penale në kapitullin e veprave penale kundër sigurisë së trafikut publik të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat janë më specifike në raport me këtë vepër penale.

Pasojat të cilat mund të paraqiten për shkak të pakujdesisë së kryerësve të kësaj vepre penale në raste të caktuara janë mjaft të rënda, andaj edhe organet e drejtësisë duhet të kenë parasysh faktin se me shqiptimin e dënimeve të arsyeshme edhe do të parandalohet kryerja e kësaj

vepre penale, pasi që edhe qytetarët tjerë do të krijojnë besimin se pakujdesia e tillë mund të dënohet ashpër dhe do të jenë më të kujdesshëm dhe më vigjilent gjatë drejtimit të mjeteve motorike.

Ky punim masteri ka për qëllim të analizojë veprën penale të rrezikimit të trafikut publik në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Drenas gjatë periudhës kohore 2015-2019, aspektin kriminalistik të kësaj vepre penale duke përfshirë veprimet e ndryshme hetimore dhe masat operative taktike të organeve proceduese për qëllime zbulimi dhe ndriçimi. Në punim gjithashtu trajtohet edhe aspekti kriminologjik i veprës penale të rrezikimit të trafikut publik, pra fenomenologjia dhe etiologjia kriminale. Në kapitullin e fundit trajtohet politika ndëshkimore e aplikuar ndaj kryerësve të kësaj vepre penale në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Drenas gjatë periudhës kohore 2015-2019.

Fjalët kyçe: Rrezikim i trafikut publik, aksident trafiku, vepër penale, politikë ndëshkimore